

NJOFTIM PËR SHTYP

Takimi i 10-të i Nivelit të lartë të Shoqatave Rajonale të Rregullatoreve të Tregjeve në Zhvillim

Kryetari i ERE-s, njëkohësisht dhe President i Medreg mori pjesë sot në takimin e 10-të të nivelit të lartë të shoqatave rajonale regullatore të tregjeve në zhvillim. Në fjalën e tij, z. Ahmeti ndër të tjera falenderoi pjesëmarrësit e këtij takimi (AFUR, ARIAE, ERERA, ERRA, MEDREG, RERA dhe OOCUR) dhe theksoi rëndësinë e bashkëpunimit dhe të shkëmbimit të eksperiencës në kuadrin e sfidave aktuale të energjisë (tranzicioni i energjisë, kriza e rritjes së çmimeve, siguria e furnizimit), për të çuar përpara progresin në vendet në zhvillim.



Fokusi, u shpreh ai, duhet të jetë në konvergencën rregullatore dhe, në planet afatgjatë në të cilën do të përfshihen aspektet e investimeve dhe të zhvillimit të interkonjeksioneve ndërkufitare.

Qëllimi i takimit është vazhdimi i ofrimit të një platforme shkëmbimi të nivelit të lartë për Shoqatat e Rregullatorëve që përfaqësojnë ekonomitë në zhvillim për të rritur bashkëpunimin dhe shkëmbimin e përvojave, njohurive, praktikave më të mira në disa fusha të rregullimit të energjisë si dhe efekteve që COVID-19 pati në tranzicionin e energjisë në vendet pjestare të shoqatave pjesëmarrëse.